



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-18
Prishtinë, më 16 prill 2015

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 16 PRILL 2015**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Aida Dërguti, nënkryetare e Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, dhe procedoi me pikat si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Agim Çeku, Melihate Tërmkolli, Visar Ymeri, Pal Lekaj, Zafir Berisha, Nenad Rashiq, Flora Brovina, Murat Hoxha, Rexhep Selimi, Teuta Haxhiu, Margarita Kadriu-Ukelli, Nait Hasani, kryeministri Isa Mustafa, dhe zv/kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Time Kadrijaj parashtoi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me atë se sa prej ministrave të Qeverisë së Kosovës kanë më shumë se një vend pune. Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Synavere Rysha parashtoi pyetje për ministrin Memli Krasniqi në lidhje me nxjerrjen e numrit të saktë të dëmeve të shkaktuara nga sëmundja e deleve dhe kafshëve të tjera, e ashtuquajtur “Gjuha e kaltër”. A parashihet kompensimi i dëmeve për blegtorët lidhur me këto humbje në bagëtitë e tyre?

Ministri Memli Krasniqi iu përgjigj pyetjes së deputetes Synavere Rysha.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me, siç tha ajo, ndërhyrjen e MAP-it në punët e brendshme të Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës, dhe

përse nuk respektohen vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në lidhje me këtë çështje.

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me atë se për çfarë arsyeje nuk i është përgjigjur letrës së Avokatit të Popullit të datës 22 shtator 2014. Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama.

Deputeti Elmi Reçica parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me veprimet konkrete të ministrisë që ai drejton, për themelimin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Elmi Reçica.

Deputeti Shpejtim Bulliqi parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me numrin e objekteve shkollë-baraka, në të cilat mbahet aktualisht procesi mësimor në Kosovë.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Shpejtim Bulliqi.

Deputeti Shpejtim Bulliqi parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me fazën e punimeve të ndërtimit të objektit shkollor në afërsi të shkollës së mesme profesionale Fan S. Noli, në Podujevë.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit Shpejtim Bulliqi.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me mundësinë e furnizimit me tekste shkollë për nxënësit e arsimit parauniversitar në Luginën e Preshevës, në vitin shkollor 2015-2016.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputeti Nait Hasani parashtroi pyetje për ministrin Avdullah Hoti në lidhje me atë se a ka shkolla fillore dhe të mesme private në Kosovë, mësimdhënësit e të cilave financohen nga Qeveria e Kosovës.

Ministri Avdullah Hoti nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Armend Zemaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me masat preventive të ndërmarra nga ministria që ai drejton, lidhur me çështjen e shkatërrimit të ambientit në Grykën e Deçanit.

Ministri Ferid Agani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Armend Zemaj parashtroi pyetje për ministrin Avdullah Hoti në lidhje me ekzistimin e fondit nga pagesat e taksës për mbrojtje të mjedisit, me rastin e regjistrimit të automjeteve, shfrytëzimin e këtij fondi dhe si u rikthehet qytetarëve të vendit ky fond.

Ministri Avdullah Hoti nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me krahasinin e gradave - titujve shkencorë që janë marrë me sistemin e vjetër katërvjeçar dhe me sistemin e ri të Bolonjës.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Luljeta Veselaj-Gutaj.

Deputetja Xhevahire Izmaqi parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me funksionimin normal dhe efikas të Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Xhevahire Izmaqi.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me atë se pse ka vazhduar referimi i pacientëve në sektorin privat dhe pse Ministria e Shëndetësisë ka paguar për këto raste në sektorin privat, kur këtë shërbim e ka organizuar në sektorin publik. Ministri Imet Rrahmani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Arban Abrashi në lidhje me atë se sa po respektohen dhe zbatohen vendimet e Inspektoratit të Punës në zbatimin e të drejtave të punëtorëve kur ka shkelje nga punëdhënësit dhe çfarë veprimesh janë ndërmarrë për zbatimin e vendimeve të Inspektoratit të Punës.

Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me rikualifikimin e mësimdhënësve të Luginës së Preshevës, të cilët e kanë përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

* * *

Në vazhdim, lidhur me rendin e ditës, për fjalë u paraqitën deputetët: Donika Kadaj-Bujupi, Nait Hasani, Adem Grabovci dhe Ismet Beqiri.

Donika Kadaj-Bujpi, në emër të tri subjekteve politike opozitare, propozoi që në rendin e ditës të seancës së sotme të shqyrtohet pika - Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.

Nait Hasani, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, propozoi që në rendin e ditës të seancës së sotme të shqyrtohet pika - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e Maturës shtetërore, i cili duhet të bëhet në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, shmangie nga Rregullorja.

Nait Hasani bëri edhe propozimin e dytë, që nga rendi i ditës të seancës së sotme të hiqet pika - Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.

Adem Grabovci - në emër të GP të PDK-së, propozoi që për rendin e ditës së punimeve të seancës së sotme, të hiqet nga rendi i ditës, pika - Emërimi i anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndërsa pika e propozuar - Propozimi i GP të PDK-së dhe GP të LDK-së për caktimin e deputetit Blerim Shala në delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë të radhitet si pikë me numër 5 e rendit të ditës.

Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që për rendin e ditës së punimeve të seancës së sotme, të hiqet pika - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Fjala e deputetëve Donika Kadaj-Bujpi, Nait Hasani, Adem Grabovci dhe Ismet Beqiri është dhënë e plotë në transkript.

Në lidhje me propozimet e Donika Kadaj-Bujpit, Nait Hasanit, Adem Grabovcit dhe Ismet Beqirit, kryetari dhe nënkryetarja, Aida Dërguti, kërkuar deklarimet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të kryetares së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Për propozimet e deputetëve, Donika Kadaj-Bujupi, Nait Hasani, Adem Grabovci dhe Ismet Beqiri u deklaruan deputetët: Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione; Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Ismet Beqiri dhe Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”; Kujtim Paçaku dhe Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi i seancës i hodhi në votim, veç e veç, propozimet e paraqitura nga deputetët: Donika Kadaj-Bujpi, Nait Hasani, Adem Grabovci dhe Ismet Beqiri.

Për propozimin e deputetes Donika Kadaj-Bujupi, rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----24,
Kundër ----- 37
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin e deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Për propozimin e parë të deputetit Nait Hasani, rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----61,
Kundër ----- 0
Abstenime -----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e parë të deputetit Nait Hasani, si dhe kjo pikë - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e Maturës shtetërore radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës së seancës së sotme.

Për propozimin e dytë të deputetit Nait Hasani, rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----46,
Kundër ----- 2
Abstenime -----6.

Kryesuesi konstatoi se për shkak të mungesës së pjesëmarrjes së deputetëve në procesin e votimit, pika - Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, mbetet pikë e rendit të ditës të kësaj seance.

Për propozimin e paraqitur nga deputeti Adem Grabovci, kryesuesi konstatoi se Kuvendi nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore të deputetëve, me shumicë votash e miratoi këtë propozim.

Për propozimin e paraqitur nga deputeti Ismet Beqiri, kryesuesi konstatoi se Kuvendi nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore të deputetëve, me shumicë votash e miratoi këtë propozim.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
4. *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA,*
5. *Propozimi i GP të PDK-së dhe GP të LDK-së për caktimin e deputetit Blerim Shala në delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë,*
6. *Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim,*
7. *Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e Maturës shtetërore.*

* * *

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 26, 27 mars e 2 prill 2015, më 27 mars 2015 dhe më 2, 3 e 7 prill 2015.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA

Në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kryetari propozoi që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës, për shkak të mungesës së kuorumit të domosdoshëm për këtë çështje, sepse ratifikimi i marrëveshjes kërkon miratimin e 2/3 të deputetëve.

5. Propozimi i GP të PDK-së dhe GP të LDK-së për caktimin e deputetit Blerim Shala në delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë

Kryetari i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i PDK-së dhe Grupi Parlamentar i LDK-së, në pajtim me pikën 4 të Rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, miratuar në seancën plenare, të mbajtur me 18 tetor 2012, kanë propozuar që deputeti Blerim Shala të caktohet koordinator i delegacionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për bisedime me Serbinë.

Kryetari hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputeti Nait Hasani, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari, më tej, e hodhi në votim propozimin e GP të PDK-së dhe GP të LDK-së për caktimin e deputetit Blerim Shala koordinator në delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----56,
Kundër ----- 1
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

Deputeti Blerim SHALA emërohet koordinator i delegacionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për bisedime me Serbinë.

6. Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim

Deputeti Fikrim Damka, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, tha se komisioni që ai drejton, në bazë të procedurave të parapara ligjore, ka bërë përzgjedhjen e kandidatit për kryesues të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe Kuvendit ia ka rekomanduar zgjedhjen e znj. Sabrije Abazi kryesuese të këtij komisioni.

Fjala e deputetit Fikrim Damka është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputetja Flora Brovina, në emër të GP të PDK-së, diskutimi i së cilës është dhënë i plotë në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim miratimin e rekomandimit për zgjedhjen e znj. Sabrije Abazi kryesuese e Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Znj. Sabrije ABAZI zgjidhet kryesuese e Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim.
2. Mandati i të zgjedhurës nga pika nr. 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.

7. Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor

Deputeti Nait Hasani, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, tha se komisioni që ai drejton e ka shqyrtuar listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, të propozuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar emërimin e tyre në seancë plenare.

Fjala e deputetit Nait Hasani është dhënë e plotë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i të cilët është dhënë i plotë në transkript.

Më pas, kryetari i lexoi emrat e kandidatëve të propozuar, sipas rekomandimit të Komisionit Funksional.

Pastaj, kryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Ai konstatoi se procedimi me votim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës do të bëhet në seancën plenare të radhës.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e Maturës shtetërore

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

Ministri **Arsim Bajrami** tha se ky projektligj rregullon mënyrën e organizimit, përmbajtjen, kushtet, kriteret dhe procedurat e provimit të maturës shtetërore.

Përafrimi i legjislacionit nga kjo fushë me standardet dhe praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare është një ndër prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, theksoi ministri.

Në vazhdim ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arsim Bajrami është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport; Bekim Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Shpejtim Bulliqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Ai konstatoi se procedimi me votim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës do të bëhet në seancën plenare të radhës.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 16:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesmbajtësi: Selman Ymeri,
Zyrtar i lartë ligjor*